



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

**FTESË PËR NEGOCIATA**

Të nderuar,

Mbështetur në VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si Agjenci e Pagesave”, i ndryshuar, në VKM nr. 1195, datë 05.08.2008, “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radioteleviziv ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”, në VKM nr. 556, datë 29.07.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 101, datë 9.2.2022 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2022”,

**Objekti i programit të spoteve/reklamave** për sektorët që do të mbështeten, nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, është si më poshtë:

- Mbështetje për kultivimin e grurit, për sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 HA, në vlerën 30.000 lekë për HA
- Mbështetje me 40 lekë për litër të karburantit për anijet e peshkimit për furnizimet nga data 1 Korrik 2022 deri 31 Dhjetor 2022.

**Nevoja për kryerjen e reklamave:** Me anë të kësaj fushate komunikimi do të bëhet i mundur realizimi i objektit: “Për aktivitetet informuese për publikun lidhur me masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2022, për mbështetje për kultivimin e grurit dhe mbështetje me 40 lekë për litër të karburantit për anijet e peshkimit”, dhe marrja e informacionit në të gjithë territorin e vendit me fokus kryesore zonat rurale.

**Të zhvillohet procedura e blerjes, zhvillimit dhe prodhimit të spoteve/reklamave:** “Për informimin mediatik të publikut të gjerë lidhur me masat e mbështetjes së programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2022, për masat e kultivimit të grurit dhe mbështetje me karburant për peshkimin”, me fond limit 4.528.100 (katër milion pesëqind e njëzet e tetë mijë e njëqind) lekë pa TVSH.

**Ideimi i spoteve/video informuese të kryhet nga organet e masmedias të specializuara në këtë fushë dhe transmetimi të kryhet nga masmedia on-line** printime roll up, printim fletëpalosje katër faqe, printim posterash një faqe, reklamim radio, video graphic, reklamim gazeta, baner graphic.

**Objekti i programit të spoteve/reklamave** për sektorët që do të mbështeten, nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, është si më poshtë:

- Mbështetje për kultivimin e grurit, për sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 HA, në vlerën 30.000 lekë për HA
- Mbështetje me 40 lekë për litër të karburantit për anijet e peshkimit për furnizimet nga data 1 Korrik 2022 deri 31 Dhjetor 2022.

## **TEKSTI DHE KONTENTI**

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall thirrjen për aplikime nga fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2022, sipas VKM nr. 556, datë 29.07.2022.

Aplikimet për masën 7/1 do të bëhen online nga data 01.09.2022 ora 08.00 deri në datën 23.09.2022, ora 22.00.

Bazuar në VKM nr. 556, datë 29.07.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 101, datë 9.2.2022 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2022”, të sektorëve që do të mbështeten dhe masës së financimit për vitin 2022, për: Masat e mbështetjes dhe masa e financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë, si më poshtë vijon:

7/1 Mbështetje për kultivimin e grurit, për sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 HA, në vlerën 30.000 lekë për HA.

7/2 Mbështetje me 40 lekë për litër të karburantit për anijet e peshkimit për furnizimet nga data 1 Korrik 2022 deri 31 Dhjetor 2022.

Thirrja për aplikime do të qëndrojë e hapur nga data 01.09.2022 deri më 23.09.2022.

Informacioni për mënyrën e aplikimit, kriteret e përfitimit dhe procedurat deri në përfitimin e mbështetjes financiare gjendet pranë 20 Agropikave në qytetet: Tiranë, Durrës, Kavajë, Lushnjë, Berat, Fier, Vlorë, Elbasan, Librazhd, Pogradec, Korçë, Përmet, Gjirokastër, Sarandë, Lezhë, Shkodër, Pukë, Kukës, Dibër, Mat.

16 zyrat e Agjencive Rajonale të Ekstensionit të Bujqësisë

Zyrave qendrore të AZHBR

Si dhe në faqen e internetit [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al)

Aplikimet për masën 7/1 do të bëhen online nga data 01.09.2022 ora 08:00 deri në datën 23.09.2022, ora 22:00.

Dokumentacioni që provon pronësinë dhe/ose përdorimin e tokës dhe dokumenti i bankës për numrin e llogarisë mund të dorëzohet në momentin e aplikimit.

Aplikimi on-line do të bëhet nga aplikanti në portalin e-Albania.

Aplikantët kur e kanë të nevojshme gjatë procesit të aplikimit asistohen online, nëpërmjet numrit jeshil 08008383, nga specialistët e Agropika-ve pranë 20 Agropikave, Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor.

Përfitues për masën mbështetëse 7/1 mund të jenë fermerë individualë, persona fizik, juridik, SHBB;

Aplikimi on-line është i mundshëm përgjatë 24-orëve nga data e hapjes deri në përfundim të periudhës së aplikimit;

Procedura e aplikimit nga portali e-Albania, përfundon me dërgimin me sukses të formatit elektronik të formularit të aplikimit.

Për masën 7/1, pas përfundimit të aplikimeve, renditja do të bëhet nga sipërfaqja më e madhe tek sipërfaqja më e vogël. Në rast të aplikimeve me të njëjtën sipërfaqe renditja do të bëhet sipas kohës së aplikimit.

Aplikimi on-line është i mundshëm përgjatë 24 orëve, nga ora 08:00, e datës së hapjes deri në orën 22:00, të datës së përfundimit të periudhës së aplikimit.

## **Aplikimi për masën 7/2**

Aplikimet për masën 7/2 do të bëhen në zyrat qendrore të AZHBR ose në Agropika;

Për qëllime identifikimi, aplikanti sipas statusit përkatës (person fizik/juridik), ose përfaqësuesi i tij me prokurë ose autorizim, duhet të paraqitet në zyrat qendrore të AZHBR-së me letërnjoftim elektronik ose pasaportë biometrike.

Përfitues për masën mbështetëse 7/2 janë subjekte të pajisur me statusin pritës të regjistruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për furnizime me karburant në Shqipëri.

Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikanti është:

- a. Kërkesë me shkrim për pagesë drejtuar AZHBR,
- b. Dokument origjinal i lëshuar nga banka e nivelit të dytë që identifikon numrin e llogarisë së aplikuesit, ku do të bëhet pagesa,
- c. Deklarata doganore IM4 (e cila ka vulë elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave), e noterizuar.
- d. Fotokopje e faturës së shitjes dhe kuponit fiskal të lëshuar nga magazinë doganore ose zonë e lirë.

## 1. 1 Video Graphic

1 Video (motion graphic) 1 video për të dy masat, për përdorim në rrjete sociale, me gjatësi jo më pak se 30 sekonda, me sfond muzikor dhe voiceover (nëse kërkohet), të përmbajë imazhe grafike shpjeguese sipas nevojës.

## 2. Fletëpalosje design dhe printim, katër faqe, 1.500 copë

- a. 4 ngjyra
- b. Letër 115 gr

## 3. Design dhe printim posterash, 1 faqe, 20 copë

- a. 4 ngjyra
- b. Letër 115 gr
- c. Format A3

## 4. Poster (banner) grafik për kryefaqen e web-it zyrtar AZHBR

- a. Dizajn me ngjyra
- b. Logo e AZHBR, MBZHR, E-Albania
- c. Përmasa sipas parametrave të dritares në faqen zyrtare AZHBR

## 5. Design dhe printim Roll up, 6 copë

- a. Përmasat 80 x 200 cm
- b. Material banner + mekanizëm përkatës
- c. Roll up do të përmbajë 1 dizajn.

## 6. Reklamim «radio»

- a. Prodhim i 1 spoti radiofonik
- b. Transmetimi i spotit radiofonik në minimumi 1 radio kombëtare dhe 3 radio lokale (duke mbuluar të gjithë territorin e vendit dhe të vihet theksi që të informohen sa më shumë zonat rurale në vend)
- c. Frekuenca jo më pak se 4 herë në ditë.

## 7. Publikimi i skemave mbështetëse për vitin 2022, në median e shkruar në minimumi 3 gazeta të përditshme, me tirazhin më të lartë, për një periudhë 7 ditore.

## 8. Organizimi i takimeve informuese me fermerë për aplikime në skemën mbështetëse kombëtare 2022, për masën e kultivimit të grurit dhe mbështetje me karburant për peshkimin me të dhëna/specifikime si më poshtë:

- Do të organizohen në total 12 (dymbëdhjetë) aktivitete në qarqet: Tiranë, Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier, Berat, Vlorë, Elbasan, Korçë, Dibër, Gjirokastër dhe Kukës;
- Shërbimi kërkohet të jetë në ambjent të hapur (outdoor) ose të mbyllur (indoor), duke respektuar rregullat dhe aktet ligjore e nënligjore të vendosura nga Institucionet për COVID 19,

- Vendndodhjet e eventit:
  - të jetë për 30-50 persona të ulur (karrike të disponueshme);
  - të ketë të instaluar sistem audio, pajisje të nevojshme, si dhe të ofrohen dhe dy mikrofona valor për diskutime nga të pranishmit.
  - asistencë teknike gjatë gjithë takimit.

9. Monitorimi i procedurës së ndjekur nga kompani e specializuar që ushtrojnë këtë aktivitet dhe monitorimin e gjithë praktikës.

## **Termet e referencës**

### **1. Fletëpalosje**

- Operatori merr përsipër të krijojë, tekstin dhe layout-in grafik të fletëpalosjeve;
- Fletëpalosja duhet të përmbajë slogan tekst logo;
- Operatori merr përsipër shërbimin fotografik për fletëpalosjen;
- Fletëpalosja duhet të përmbajë logon e AZHBR MBZHR;

Afati i dorëzimit 4 (katër) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

### **2. Poster**

- Operatori merr përsipër të krijojë konceptin tekstin dhe layout grafik të posterit, me kompozim të ndryshëm për masat mbështetëse
- Posterit duhet të përmbajë fotografi, slogan tekst
- Operatori merr përsipër shërbimin fotografik për posterin
- Posterit duhet të përmbajë logon e AZHBR, MBZHR.

Afati i dorëzimit 4 (katër) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

### **3. Roll up**

- Operatori merr përsipër të krijojë konceptin tekstin dhe layout grafik të posterit, me kompozim
- Roll up do të përmbajë 1 dizajn
- Roll up duhet të përmbajë slogan tekst logo
- Operatori merr përsipër shërbimin fotografik për fletëpalosjen
- Roll up duhet të përmbajë logon e AZHBR MBZHR

Afati i dorëzimit 4 (katër) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

### **4. Organizimi i aktiviteteve:**

- Aktivitetet do të zhvillohen gjatë periudhës së përcaktuar në kalendarin që do t'i vendoset në dispozicion operatorit nga AZHBR;
- Operatori ekonomik merr përsipër transportin e materialeve të përcaktuara sa më sipër si karrige, banner, stafin e promocionit, blerjen e maskave mbrojtëse etj;
- Operatori ekonomik merr përsipër organizimin e aktiviteteve përkatëse sipas specifikimeve teknike;

**5. Monitorimi i gjithë procedurës së ndjekur nga kompania të specializuara që ushtrojnë këtë aktivitet .afati i realizimit të shërbimeve si më sipër do të jetë deri në përfundim të afatit të skemave kombëtare.**

Fondi limit është 4.528.100 (katër milion e pesëqind e njëzet e tetë mijë e njëqind) lekë pa TVSH.

➤ **Dokumente ligjore që duhen paraqitur, si kriter kualifikues:**

- Ekstrakt historik i QKR, që vërteton se Operatori Ekonomik ushtron aktivitet ekonomik tregtar që përputhet me objektin e procedurës dhe është aktiv.
- Dokument nga organet kompetente që vërteton se operatori ekonomik ka shlyer detyrimet fiskale, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për periudhën koherente.
- Vërtetim të xhiros vjetore të realizuar gjatë 3 viteve 2019-2020-2021.
- Vërtetim për numrin e punonjësve për periudhën Janar 2022-Korrik 2022.
- Vetëdeklarim mbi gjendjen gjyqësore, ku shprehet se Operatori ekonomik nuk ka ndjekje penale, si dhe nuk është dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata, që lidhet me aktivitetin profesional.

➤ **Dokumentacioni financiar, si kriter kualifikues**

- Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë bankare së bashku me nr. IBAN
- Kontratë të ngjajshme të realizuar gjatë tre viteve të fundit me shtetin (referencë ose kontratë) dhe/ose me subjekte private (faturat përkatëse dhe/ose kontrata).
- Sigurimin e ofertës në masën 2% të vlerës së fondit limit;
- Deklaratën që subjekti nuk është në konflikt interesi;
- Deklaratën që i përmbush specifikimet dhe termat e referencës, deklaratën e konfidencialitetit;
- Formularin e ofertës;
- Media plan paraprak për shpërndarjen/transmetim;

Dokumentacioni të jetë origjinal ose kopje e noterizuar dhe duhet të jetë lëshuar brenda tre muajve nga data e zhvillimit të procedurës.

## **Kriteret e vlerësimit të subjekteve janë :**

**Vlerësohet me 35 (tridhjetë e pesë) pikë;** Projekt-ideja e realizimit të spoteve/reklamave, e cila përmban idejëm/krijim, regji, montazh, grafike, efekte vizive dhe audio, etj.

*Projekt ideja do të vlerësohet nga Komisioni, në varësi të projekt idesë më të mirë të paraqitur.*

**Vlerësohet me 30 (tridhjetë) pikë;** Koha e blerë për transmetimin e Spoteve/reklamave (sipas logjikës së formulës më poshtë).

KT- Koha Televizive

KTM- Koha televizive më e madhe

KTV- Koha Televizive e që vlerësohet

$$KT = \frac{30 * KTV}{KTM}$$

**Vlerësohet me 35 (tridhjetë e pesë) pikë;** oferta më e ulët ekonomike në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta (sipas logjikës së formulës më poshtë).

OE- Oferta ekonomike

OU- Oferta më e ulët

OV- Oferta që vlerësohet

$$OE = \frac{35 * OU}{OV}$$

**Vlerësimi përfundimtar = pikët për projekt idenë + pikët për Kohën e blerë për transmetimin + pikët për ofertën ekonomike.**

Oferta duhet të jetë origjinale si dhe dokumentacioni i kërkuar më sipër duhet të jenë të futur në zarf jo transparent, të mbyllur, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën tuaj.

Mbi zarf të jetë shënuar “**ofertë për shërbimin**”. Përzgjedhja e ofertave do të realizohet sipas VKM nr. 1195, datë 5.8.2008, dhe kriterve të përshkruara dhe metodologjisë me sistemin e pikëve.

Monitorimi i publicitetit do të kryhet sipas përcaktimeve që do të vendosen në kontratën e shërbimit ndërmejt palëve.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë AZHBR në datën **11.08.2022, ora 14:00**.

Në procesin e hapjes së ofertave kanë të drejtë të marrin pjesë Ofertuesit, apo personat me autorizim.

Komisioni pret konfirmimin nga organet e masmedias/të Agjencive të specializuara për vazhdimësinë e negociatave, brenda afatit të fundit të paraqitur në ftesën për negociata.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë jashtë këtij afati dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Pas analizimit të ofertave, të paraqitura nga organet e masmedias/agjencitë e specializuara, komisioni përzgjedh, në bazë të pikëve, organet e masmedias/agjencitë e specializuara, duke u bazuar në kushtet e veçanta, të përcaktuara.

Ju falemnderit për bashkëpunimin.